

THIRRJE E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË  
BUKA SH.A.

**BUKA sh.a.**, është një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e themeluar më datë 17.10.1995, dhe regjistruar më datë 01.01.1996; e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ("QKR") dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve ("QRA") me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) J62013013A ("Shoqëria"). Shoqëria ka një kapital prej 239,000,000.00 leke, të ndarë në 283,104 aksione me vlerë nominale 844,21 lek secili. Administratori i Shoqërisë është Z. Hysen Caka.

Me përfundimin e procesit të shitjes nëpërmjet ankandit të paketës së aksioneve të zotëruara nga Shteti Shqiptar nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes ("MZHETTS"), Shoqëria thërret Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve ("Asambleja"), e cila do të mbledhet në selinë e Shoqërisë BUKA sh.a., Rr. Kavajës (përpara Birra Tiranë), më datë 16 Shtator 2015, në ora 11:00, sipas rendit të ditës të mëposhtëm:

1. Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë dhe miratimi i Statutit të Ri të Shoqërisë;
2. Largimi i Anëtarëve aktualë të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë;
3. Propozimi, zgjedhja, shpërblimi anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë;
4. Propozimi dhe caktimi i ekspertëve kontabël të autorizuar të Shoqërisë;
5. Miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve;
6. Të tjera.

Ftohen të gjithë Aksionarët e Shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre (konform kërkesave të ligjit të aplikuar), të marrin pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në vendin, datën dhe orën e sipërcituar. Përfaqësimi në Asamble do të bëhet konform dispozitave të nenit 140 të Ligjit no 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" dhe Statutit të Shoqërisë.

Një kopje e statutit të ri të Shoqërisë, të propozuar, për tu konsultuar nga aksionarët e Shoqërisë, si dhe të gjitha dhe çdo dokument dhe/ose informacion në kuadër të rendit të ditës së mësipërm, mund të tërhiqen në çdo moment (i) në selinë e Shoqërisë, ose (ii) në faqen zyrtare të Shoqërisë në internet: [www.buka-sha.com](http://www.buka-sha.com), ose (iii) të kërkojnë formë elektronike në adresën: [info@buka-sha.com](mailto:info@buka-sha.com)

Kjo thirrje publikohet konform Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" dhe veçanërisht nenit 137 të këtij ligji, dhe Statutit të Shoqërisë.

Për çdo pyetje, sqarim, informacion të mëtejshëm, sugjerim dhe/ose kërkesë në lidhje me rendin e ditës si dhe marrjen e dokumentacionit, mënyrës së thirrjes së kësaj mbledhjeje Asambleje, mënyrës dhe procedurave të përfaqësimit dhe votimit konform dispozitave të Ligjit no 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionarët e Shoqërisë (i) mund të paraqiten në selinë e Shoqërisë çdo ditë (E Hënë – E Premte) nga ora 14.30 – 16.00; (ii) të shkruajnë në postën elektronike [info@buka-sha.com](mailto:info@buka-sha.com); (iii) të shkruajnë nëpërmjet postës së regjistruar në adresën e Shoqërisë, duke përcaktuar qartë emrin dhe adresën e aksionarit dërgues; apo (iv) të konsultojnë faqen zyrtare në internet të Shoqërisë: [www.buka-sha.com](http://www.buka-sha.com). Aksionarët apo përfaqësuesit e tyre duhet të kenë me vete një mjet identifikimi (kartë identiteti/pasaportë) dhe në rast përfaqësimi edhe prokurën e noteruar.

